RAPORT INDIVIDUAL I KONSULTIMIT PUBLIK

për projektligjin:

“Për produktet mjekësore veterinare”

1. Titulli i projekt aktit

“Për produktet mjekësore veterinare”.

Qëllimi i këtij projektligji është krijimi i një kuadri ligjor të plotë dhe të harmonizuar për rregullimin e produkteve mjekësore veterinare, duke përcaktuar rregullat për futjen e tyre në treg, prodhimin, importin, eksportin, furnizimin, shpërndarjen, farmakovigjilencën, kontrollin dhe përdorimin e tyre.

Projektligji synon gjithashtu garantimin e sigurisë së ushqimeve me origjinë shtazore, nëpërmjet përcaktimit të rregullave dhe procedurave për vlerësimin dhe klasifikimin e substancave farmakologjikisht aktive, përcaktimin e kufijve maksimalë të mbetjeve të këtyre substancave në ushqimet me origjinë shtazore, si dhe përcaktimin e pikave të referencës për veprim për substancat për të cilat nuk është përcaktuar një kufi maksimal i mbetjeve.

Nëpërmjet këtij projektligji përcaktohen, gjithashtu, rregullat për tregtimin, ndalimin dhe përdorimin në kafshët ushqim-prodhuese të substancave me veprim hormonal ose tireostatik dhe të ß-agonistëve, me qëllim parandalimin e përdorimit të papërshtatshëm ose të paligjshëm të tyre dhe mbrojtjen e shëndetit të konsumatorit.
Në tërësi, projektligji synon garantimin e cilësisë, sigurisë dhe efikasitetit të produkteve mjekësore veterinare, mbrojtjen e shëndetit të kafshëve dhe të shëndetit publik, forcimin e sistemit të farmakovigjilencës, përmirësimin e gjurmueshmërisë dhe kontrollit të këtyre produkteve, si dhe kufizimin e zhvillimit dhe përhapjes së rezistencës ndaj antimikrobikëve.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për

shkurtimin e kohëzgjatjes.

Publikimi i projektligjit u bë në datë 31.7.2026 dhe nëpërmjet një njoftimi të publikuar online në RENJKP, të gjitha palët e interesuara:

- organet publike;
- shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit;
- personat fizikë të huaj me vendqëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, si dhe
- personat juridikë të huaj, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë,x

ishin të ftuar për të paraqitur komentet dhe rekomandimet e tyre për projektaktin, në adresën e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik.
Data e mbylljes së procesit të konsultimit ishte 28.8.2026.

Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 1006 shikime në platformën online, por nuk janë regjistruar komente në RENJKP. Komentet janë dërguar në adresën e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik.

Gjithashtu u organizua një takim me grupet e interesit në MBZHR, në datë 24.9.2026.

3. **Metoda e konsultimit**

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese…, dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për projektligjin "Për produktet mjekësore veterinare", ishin:

- Konsultimi elektronik përmes Regjistrit Elektronik, RENJK (31.7.2026 – 28.8.2026);
- Tryezë publike me grupet e interesit, në datë 24.9.2026, në MBZHR;
- Nëpërmjet postës elektronike.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.
Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.
Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Projektligji është përgatitur nga një grup ndërinstitucional pune me urdhër të ministrit nr.169, datë 19.2.2026 "Për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e projektakteve të planifikuara në zbatim të programit të përgjithshëm analitik të projektakteve për vitin 2026".

Palët e interesit që u përfshinë në takimin e organizuar nga MBZHR, ishin si më poshtë:

- Federata Kombëtare e Bletërritësve të Shqipërisë, me përfaqësues Kryetarin z. O. Rraku;
- Z. Luan Kullolli, subjekti "Imi-Pharma" sh.p.k.,
- Z. Gridi Bozdo, subjekti "Imi-Pharma" sh.p.k.,
- Z. Edmond Xherahi, subjekti "Alvet" sh.p.k.,
- Z. Artan Pellumbi, subjekti "Milifar" sh.p.k.,
- Z. Andi Loloci, subjekti "Vetal" sh.p.k.,
- Znj. Denata Shehdula, subjekti "Shehdula" sh.p.k.,
- Z. Adi Bulku, subjekti "Isuf Bulku" sh.p.k.,
- Z. Ermal Pepa, subjekti "Farmvet Lezha" sh.p.k.

Nga ky takim fizik u ofruan sqarimet dhe orientimet e nevojshme lidhur me projektligjin. Subjektet pjesëmarrëse u njohën me përmbajtjen e tij dhe, pas diskutimeve të zhvilluara, nuk pati kundërshtime, vërejtje apo sugjerime.

Gjatë prezantimit të projektligjit u paraqitën qëllimi, objektivat dhe risitë kryesore të parashikuara në të. Pjesëmarrësit diskutuan mbi aspekte të ndryshme të tij, përfshirë autorizimin e tregtimit të produkteve mjekësore veterinare, rolin dhe përgjegjësit e operatorëve ekonomikë, mekanizmat e kontrollit dhe monitorimit të produkteve mjekësore veterinare, si dhe çështje që lidhen me zbatimin praktik të dispozitave. Diskutimet evidentuan një qasje pozitive ndaj draftit, pa

kundërshtime për përmbajtjen e propozuar.

5. Pasqyra e komenteve të pranuara me arsyetimin e komenteve të pranuara/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuara sipas çështjes që ato ngritën;
Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;
Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Nga procesi i konsultimit të projektligjit, ka patur 7 (shtatë) rekomandime, nga të cilat 1 (një) u pranua plotësisht dhe 6 (gjashtë) u refuzuan.

- Dy sugjerime u refuzuan, pasi komenti gjen zgjidhje në një projektakt tjetër ligjor/nënligjor.

- Katër sugjerime u refuzuan, pasi çështja është e rregulluar qartë në projektakt ose ndërhyrjet prekin teknikën legjislative të projektaktit.

Çështja e adresuar	Komenti	Palët e interesuara	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
1. Lidhur me importin e medikamentev të aprovuara nga KE.	Propozim për: "Lejimin e Importeve në Republikën e Shqipërisë vetëm të Medikamenteve të aprovuara nga Komuniteti Evropian.(Pavarësisht vendin e Prodhimit)."	z. Odhisea Rraku	U refuzua	Ligj nr. 10 465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në republikën e Shqipërisë", në nenin 85 përcakton që në Shqipëri pranohen vetëm produkte mjekësore veterinare të cilat kanë një autorizim tregtimi të lëshuar nga Agjencia Evropiane e Medikamenteve

				(EMA) ose një shtet anëtar i BE. Ndërsa nuk mund të pranohen produkte mjekësore veterinare të cilat nuk janë autorizuara dhe kontrollohen nga shteti anëtar i BE që ka lëshuar autorizimin e tregtimit. Projekt ligji përforcon masat përsa i përket importit të produkteve mjekësore veterinare nga vendet e Bashkimit Evropian. Sa më lart propozimi nuk pranohet duke qenë se çështja është tashme e zgjidhur.
2. Lidhur me kontrrollin e tregut të medikamente ve në Shqipëri.	Propozim për: "Kontrollin dhe survejimin e vazhdueshëm të tregut të Medikamenteve në Shqipëri dhe sidomos të Farmacive Veterinare."	z. Odhisea Rraku	U refuzua	Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, bën tashme kontroll të vazhdueshëm të farmacive veterinare dhe importuesve të produkteve mjekësore veterinare. Projektligji përmban rregulla më shteruese në fushën e kontrollit të cilat do të plotësohen me akte nënligjore që përafrojnë aktet përkatëse të BE. Sa më lart propozimi nuk u pranua duke qenë se

				çështja është tashmë e zgjidhur.
3. Ndarja në 5 territore të Hartimit të Protokollit Komëtar të trajtimeve.	Propozim për: Hartimi i një Protokolli Kombëtar trajtimesh duke e ndarë territorin e Shqipërisë në 5 Zona - Zona Jug-Perëndimore - Zona Jug-Lindore - Zona e Shqipërisë së Mesme. - Zona Veri-Perëndimore. - Zona Veri - Lindore.	z. Odhisea Rraku	U refuzua	Trajtimet mjekësore veterinare nuk mund të bëhen ndryshe nga një zone e Shqipërisë në një tjetër. Trajtimet behën nga mjeket veterinare duke u mbështetur në diagnozën e sëmundjes dhe gjendjen e produkteve mjekësore veterinare.
4. Lidhur me monitorimin e procesit të protokollit të trajtimeve.	Propozimi: Monitorimi në mënyrë sistematike i këtij Protokolli nga Veterinaret e Zonës dhe Specialistët e fushës.	z. Odhisea Rraku	U refuzua	Propozimi nuk pranohet, me të njëjtin argumentim si pika më lart.

5.Lidhur me apdetimin e listës së medikamenteve të lejuara nga MBZHR.	Propozimi për: Apdetimi i përvitshëm i listës së Medikamenteve të lejuara nga Ministria e Bujqësisë.	z. Odhisea Rraku	U refuzua	Lista e produkteve mjekësore veterinare nuk përditësohet një herë në vit. Ajo përditësohet pas çdo vendimi të Komisionit Shtetëror të Produkteve Mjekësore Veterinare. Propozimi nuk pranohet.
6. Lidhur me Regjistrin e Fermës	Propozimi: Riformatimi i regjistrit të Fermës duke u bazuar në kërkesat e reja që janë paraqitur dhe duke e përshtatur atë në formatin e vendeve të KE dhe Monitorimi i rregullt i tij nga Veterinerët e Zonave dhe Specialistët e fushës.	z. Odhisea Rraku	U refuzua	Regjistrimi i fermave përcaktohet nga Ligji Nr. 10465, datë 29.09.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar). Mbi këtë baze është ngritur dhe mbahet sistemi elektronik RUDA, i cili përditësohet në mënyrë të vazhdueshme. Propozimi nuk pranohet, pasi nuk është subjekt i këtij projektligji.
7.Lidhur me një proces bashkëpunimi të vazhdueshëm ndërmjet MBZHR dhe	Propozimi: Mbajtja në kontakt të vazhdueshëm midis Min. së Bujqësisë dhe Federatës Kombëtare të Bletërritësve të Shqipërisë, pasi	z. Odhisea Rraku	U pranua	Propozimi pranohet. MBZHR ka zhvilluar takime informative me bletarë dhe blegtorë sa herë është e nevojshme dhe do të vazhdojë me këtë praktike pune.

Federatës Kombëtare të Bletërritësve.	këta të fundit kanë mundësi dhe janë në kontakt të vazhdueshëm me Bletërritësit dhe Shoqatat Lokale të Bletarisë, me qëllim evidentimin dhe denoncimin e abuzuesve, të cilët prodhojnë në mënyrë Primitive dhe jashtë çdo standardi Medikamente, brenda territorit të Shqipërisë, ose Importimin e tyre në mënyrë Kontrabandë duke dëmtuar Bletarinë dhe duke rrezikuar shëndetin e Konsumatorit.			